

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"O kukull, projektligji për kinemanë do deformat filmin duke futur video-lojëra", Mevlan Shanaj përballet l ive në 'Ftesë në 5" me drejtorin e QK, Jorgji: Po flitet keq për njerëz që punojnë
ADRESA	https://top-channel.tv/2026/09/14/ke-marre-fonde-kthe-leket-debat-i-ashper-mes-mevlan-sh anajt-dhe-jonid-jorgjit-regjisori-o-kukull-mos-ju-lepini-ministrit-ne-te-nxjerrim/
BURIMI	top-channel.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 18:45:24 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	14 shtator 2026, 17:23:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 14 shtator 2026, 17:22:00 UTC → 14 shtator 2026, 17:24:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	43c70161687ed2a6c3ab383896e86a10d0599dce1d643b32feb459b2027739cb
TEKSTI	e65dc72a8b20d7fb11918a2bcba9b2608ff1218bd95c858f098458a067a1c798
PAMJA	cff68939262fadba791dd6ad1ccd7a8ed2a07ae5e4b0e26f24824aea5fdb5fd

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4fa8aacf23977ed765897af36e6b0b5eda45235178963725e463f70bdf1df50
E MËPARSHMJA	8489bc0b2a6a0e7edc6fe283bc28108677c43c06e8066521692787398396e96a
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4fa8aacf23977ed765897af36e6b0b5eda45235178963725e463f70bdf1df50>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

KULTURË TË FUNDIT

"O kukull, projektligji për kinemanë do deformatë filmin duke futur video-lojëra", Mevlan Shanaj përballë live në 'Ftesë në 5' me drejtorin e QK, Jorgji: Po flitet keq për njerëz që punojnë

14/09/2026 19:23



PROJEKTIGJI PËR KINEMATOGRAFINË!
KINEMA SHQIPTARE APO NJË "SERVIS SHQIPTAR" PËR PRODUKSIONET E HUAJA?

Të ftuar në "Ftesë në Pesë" me Bieta Sulon ishin aktori dhe regjisori Mevlan Shanaj, përballë drejtorit të Qendrës Kinematografike, Jonid Jorgji dhe producentit Ols Abazi.

Debat i nisur javën e shkuar lidhur me projektligjin për kinematografinë shqiptare duket se është nxehur më tej.

Të dy u përplasën ashpër, për herë të parë përballë njëri-tjetrit në studio.

Mevlan Shanaj: Ju falënderoj që më jepni mundësinë të jem përballë këtij zotërisë, që është kryetar i Qendrës Kinematografike, ose duhet të them këtë djalë, sepse nuk është në pozicionin e Kryetarit të Qendrës. Po të dojë ai, ja argumentoj edhe këtë.

Unë reagoja te festivali, sepse nuk ka rëndësi, një festival ikën, vjen tjetri, por për qëllimin e madh, për deformimin që do t'i bëhet ligjit të kinemasë. Është një ligj që është bërë në '96, me një mision shumë të madh, duke e shkëputur Qendrën Kinematografike nga shteti dhe duke e bërë institucion të pavarur dhe në krye ishte një profesionist si Anagnosti.

Ky ligj vazhdoi deri më sot. Sot kërkojnë ta përmirësojnë, por në vend që t'i vënë vetullat, po i nxjerrin sytë.

Edhe ju e keni lexuar që Qendra Kinematografike do të bëhet agjenci audiovizuale, do të prodhohen edhe videolojëra. Në një kohë që unë them që Shqipëria të ndërtojë në mënyrë të pavarur Qendrën e Filmit, të rritet buxheti, të mbetet vëmendja ndaj filmit shqiptar, të kihet kujdes ndaj autorëve shqiptarë dhe, për sa i takon buxhetit, e dini ju që buxheti më i lartë ka qenë 1.6 milionë euro, në një kohë kur vendet përreth nesh e kanë disa herë më shumë.

Këta zotërinjtë që rrinë nën një strehë me Ministrin e Kulturës, të mos i lëpohen atij, duke pirë kafe me njëri-tjetrin, por të shohin ku është filmi shqiptar, si trajtohet krijuesi shqiptar. Pra, me plot gojë, të marrin mendim çdo njeri i ditur dhe me përvojë si unë, që jam profesionist dhe jo njeri politik.

I Kryesore



Gjykata e Lartë merr vendimin për Veliajn, kryebashkiaku mbetet në burg

11:06

Gjendet një automjet i djegur në zonën e Cerkovinës, dyshohet se është vjedhur kohë më parë për veprimtari të paligjshme

09:41

Trump çmonton politikat e Biden për klimën: Më shumë qymyr dhe gaz natyror për prodhimin e energjisë elektrike

09:30

FOTO/ Zendaya, Selena Gomez dhe yjet e Hollywood-it shkëlqejnë në tapetin blu të Emmy Awards

08:15

"Camp Nou" dhe "Wembley" në garë për të pritë finalen e Champions League, sot pritet vendimi i UEFA-s

08:34

I Më të lexuarat

Mbyllet gjyqi ndaj Thaçit në Hagë! Procesi për pengim të drejtësisë, mbrojtja kundërshtoi transkriptet e prokurorisë dhe kërkoj pafajësi

25 mijë euro vetëm pishina/ Email-et dhe dokumentet në dosje, SPAK ia atribuon vilën Belinda Ballukut. Heshtin "Atelier 4" dhe "Green Coast"

Mbretëria e Bashkuar po dridhet/ Skocia, Uells dhe Irlanda e Veriut kërkojnë referendum: E ardhmja jonë është në BE

Tensionet zhvendosen në hapësirë, SHBA pranon se ka armë në orbitë: Rusia dhe Kina konsiderohen kërcënimet kryesore

"O kukull, projektligji për kinemanë do deformatë filmin duke futur video-lojëra", Mevlan Shanaj përballë live në 'Ftesë në 5' me drejtorin e QK, Jorgji: Po flitet keq për njerëz që punojnë

Nga një 'like' në Instagram te propaganda serbe, si u shemb skandali i 'kushteve të këqija' në Tiranë

"FBI kishte mijëra përgjime për Al Caponen, por s'kishte prova", Filip Çakuli: Veliajn e arrestuan nga thashethemet, e linçuan publikisht

"China Zorrilla", anija më e madhe elektrike në botë mbërrin në Uruguai, nis udhëtimet

Këta janë viktime të politikës së emëruar. Nuk ka Mevlan Shanaj asnjë politikë të majtë apo të djathtë dhe mos tund kokën ti, Jorgji. Dëgjo mirë, se je duke u sjellë në mënyrë skandaloze. Unë të ftova kur bëra filmin e Nikolla Zoraqit dhe ti, për detyrim, duhet të vije, sepse ishin paratë e shtetit, jo të xhepit tënd. Nuk erdhe ta shikoje. Filmi u shfaq dy herë në Tiranë dhe një herë në Korçë, u shfaq në Prishtinë dhe koka jote që tundet është koka e një kukulle.

O Kukull, nuk sillesh dot ti me Mevlan Shanaj kështu, sepse, siç je emëruar atje nga politika, me shqelma të nxjerrin jashtë ne profesionistët.

Unë po flas për ligjin, nuk kam asgjë personale. Unë po them që ligji për kinemanë po deformohet nga njerëz të paditur, duke futur videolojëra dhe duke e quajtur atë agjenci shërbimi. Jo, kjo nuk shkon.

Duhet të rritet kapaciteti i filmit shqiptar, të rritet buxheti, të merret qeveria me filmin dhe njerëz profesionistë dhe jo amatorë.

E dini ju që këta nuk e kanë treguar se kush është ky grup që e ka krijuar projektligjin për filmin. Këta shkelin padrejtësisht në profesionin që i është dhënë. Ai është një pozicion i shenjtë, të kesh në dorë të menaxhosh një institucion të pavarur, por nuk kanë faj, sepse edhe kryeministrat me radhë, nga Rama dhe Berisha, kanë ndërhyrë.

Atje ka një bord që përcakton kapacitetin, nivelin e filmave. Ata marrin në telefon dhe thonë: "Ti jepet film këtij", duke e motivuar politikisht. Jo, dhe jo ai është një institucion i pavarur.

Në Shqipëri nuk ka asgjë që bëhet jashtë politikës. Unë po akuzoj administratën. Qendra Kombëtare e Filmit nuk ka administratë, ka njerëz që i nënshtrohen mendimeve të ndryshme ose interesave të ndryshme ekonomike.

Rreziku është katastrofal. Po dëmtohet mbrojtja dhe ndërtimi i filmit shqiptar, duke i futur emërtime që s'kanë lidhje me filmin shqiptar. Duhet të rritet buxheti dhe të mbrohen autorët.

Jonid Jorgji: Ndodhem në një pozitë të sikletshme. Mevlanin e kam pasur profesor dhe më vjen keq që flitet në këtë mënyrë për ata njerëz që punojnë atje për të bërë ligje.

Të bësh një ligj të ri është një punë kolosale. Ligji i vjetër ka qenë i shkëlqyer për kohën, por në 30 e ca vjet, çdo ligj ka nevojë për modernizim, për përmirësim.

Në Qendrën tonë ne kemi ekspertë shumë të mirë, të cilët kanë përpiluar ligjin.

Shanaj: Ke ekspertin e kafeve? Cilët janë ekspertët? Dua emrat.

Por situata u përkeqësua më tej kur Jonid Jorgji i kujtoi disa fonde që, sipas tij, aktori kishte marrë.

Jonid Jorgji: "Ke marrë fonde dhe nuk ke bërë asgjë, kthe lekët".

Drejtori i Qendrës Kinematografike iu drejtua aktorit, duke i thënë se me paratë e marra ai nuk kishte zhvilluar apo realizuar asgjë, sipas programit për të cilin kishte përfutur fondet.

Top Channel

ne tetor

"Korrupsion, dy vila të fshehura si rryshfet dhe 8 akuza për tenderat", analisti Sulo ngre alarmin: Ç'po ndodh me SPAK? Askush me këto akuza s'i ka shpëtuar arrestit

Kontrollet e reja kufitare të hyrje-daljeve, nëntë vende të BE-së shtyjnë zbatimin e plotë të masave, si do të funksionojë

I Kulturë »



Fyelli që nuk hesht në Gramsh/ Demir Buzi ruan traditën shumë vjeçare, të rinjtë i bashkohen ansambllit artistik

13/09 20:17



82-vjetori i Çlirimit të Beratit/ Homazhe dhe nderime në Varrezat e Dëshmorëve, i pranishëm në ceremoni edhe ministri Ervin Demo

13/09 13:50



Çmimet e Festivalit të Filmit, "Një filxhan kafe dhe këpucë të reja veshur" i Gentian Koçit shpallet filmi më i mirë

13/09 13:40





Shpëtohen 90 banesa historike, ndërhyrjet nisin më 2027 në pronat ku trashëgimtarët nuk kanë investuar

13/09 13:21



"Xixëllonjat e dimrit"/ Artur Gorishti debuton si regjisor, një film për shpirtin, fajin dhe kërkimin e faljes

12/09 23:05



Nga Roma drejt Muzeut të Tiranës, statuja Dea e Butrintit rikthehet në shtëpi

11/09 17:24

Na ndiqni:



I Video »



Top News – Makina e vjedhur digjet në Vlorë/ Mjeti mund të jetë përdorur në ngjarje kriminale



Top Channel/ SHBA ka vendosur armë në hapësirë: Janë në orbitën e Tokës, sulmojmë nga kozmosi!



Top Channel/ NATO rrëzon një dron në Lituani, Rusia dhe Ukraina shkëmbejnë sulme!



Top News – Ndezi disa vatra zjarri në Borsh. Policia kap në flagrancë 52-vjeçar, arrestohet



Top News – Dosja 'Revanshi'. GJKKO dënon 7 persona, Durim Bami merr 10 vite burg



Top News – NATO rrëzon dronët mbi Lituani. Polonia ngre avionët, Rusia 'alarmon' Baltikun

Lajme

Lajmet e fundit
Politikë
Kronikë
Aktualitet
Ekonomi
Sociale
Video
Top News LIVE

Bota

Opinion
Koment
Kosova dhe Rajoni
Shkencë dhe Teknologji
Auto

Sport

Kombëtarja
Kategoria Superiore
Kategoria e Parë
Premier League
La Liga
Serie A
Shumësportësh
Sport Gossip

Pop News

Showbiz
Lifestyle
Fashion
Shëndeti
Dieta
Receta gatimi

Programe

Big Brother VIP
Për'puthen
Shqipëria LIVE
Fiks Fare
Video
Të gjitha programet
Guida TV

Top Channel

Rreth Top Channel
Bileta
Kontakt
Puno në Top Channel
Privacy Policy & Terms of Use
Aksesueshmëria

© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.